

Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	Programe të ndryshme të KCSF-së
Titulli i kontratës:	Objekt me qira për KCSF

HYRJE

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

SPECIFIKAT E PRODUKTIT APO SHËRBIMIT

Kushtet teknike të kërkuara nga KCSF janë:

- Objekti i ofruar duhet të ketë sipërfaqe të shfrytëzuar me dy njësi, njësia e parë të paktën 160 m² dhe njësia e dytë të paktën 80 m²
 - i. për njësinë e parë nevojitet hapësirë për zyre të paktën 120 m² dhe një hapësirë për sallë të takimeve preferohet të paktën 40 m²
 - ii. për njësinë e dytë nevojitet hapësirë për zyre të paktën 80 m²
- Lokacioni i objekti të ofruar duhet të jetë në Prishtinë në lagjen Lakrishte, Qytezën Pejton, Dardani ose Qendër
- Objekti duhet të jetë i gatshëm për shfrytëzim dhe të posedojë infrastrukturë të nevojshme (i kështu në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, rrymës elektrike, internetit, etj.)
- Në rast që ka nevojë për modifikime për t'u përshtatur me nevojat e KCSF-së, ato duhet të jenë minore dhe të realizueshme në një periudhë të shkurtë kohore
- Objekti duhet të ketë qasje të lehtë, të papenguar dhe reprezentative për punë me palë të jashtme
- Objekti duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyror në gjithë ose pjesën më të madhe të hapësirës së punës
- Objekti duhet të posedojë sistemin e ngrohjes qendrore (në mungesë të këtij sistemi kontraktori duhet të ofrojë në objekt sistem të ngrohjes me alternativa tjera të qëndrueshme si rrymë, etj)
- Objekti duhet të posedojë sistemin e ftohjes/klimatizimit (në mungesë të këtij sistemi kontraktori duhet të ofrojë në objekt sistemin e ftohjes/klimatizimit)
- Objekti duhet të ketë një hapësirë të dedikuar për kuzhinë, më së paku instalimet e nevojshme të ujit dhe rrymës për pajisje të kuzhinës
- Objekti i ofruar duhet të ketë së paku një WC për gra dhe një për burra për secilën njësi
- Nëse objekti i ofruar ndodhet me etazhe apo në objekt banesor, për shkaqe sigurie duhet të ketë shkallët emergjente
- Objekti duhet të ketë qasje për personat me nevoja të veçanta
- Objekti duhet të ketë minimum një hapësirë për parking të dedikuar për veturat e KCSF-së

- Nëse oferta konsiderohet si ofertë substancialisht e përgjegjësme, personi juridik/fizik i rekomanduar/propozuar për kontratë, do të kërkohet që të sjellë dëshmitë për të gjitha shërbimet komunale – faturat e paguara për rrymë, uji, mbeturina, etj. si dhe dokumentacionin e nevojshëm mbi pronësinë e objektit
- Të gjithë të interesuarit preferohet të ofrojnë planet e objekteve të detajuara me metrazhe, nëse posedojnë një dokument të tillë
- Me ofertë, të ofrohen pamje të objektit (fotografi) nga brenda dhe jashtë dhe adresa e saktë e vendndodhjes së objektit

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM

DEKLARATA NËN BETIM NGA PERSONI JURIDIK/FIZIK DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin Deklaratën nën betim për kriteret e përjashtimit dhe parandalimi i konfliktit të interesit (shih Shtojcën 2), të nënshkruar nga përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose personi fizik dhe duke cekur datën, duke deklaruar se ata nuk janë në një nga situatat e përjashtimit të renditura në Shtojcën 2.

PROPOZIMI TEKNIK

Propozimi teknik duhet të mbulojë të gjitha elementet e kërkuara në specifikimin teknik dhe të sigurojë të gjithë informacionet e nevojshme për të zbatuar kriteret e dhënies së kontratës. Ofertat që devijojnë nga kërkesat ose nuk mbulojnë të gjitha kërkesat mund të refuzohen në bazë të mosrespektimit të specifikimeve të tenderit.

PROPOZIMI FINANCIAR

Çmimi në propozimin financiar duhet të kuotohet në euro. Çmimet duhet të kuotohen pa përfshirë TVSH-në por duke përfshirë tatimin në burim dhe shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

Objekti duhet të merret me qira për përafërsisht 5 vjet për njësinë e parë (deri më 1 gusht 2026), dhe përafërsisht 2.5 vjet për njësinë e dytë (deri më 31 dhjetor 2023).

Komisioni i përcaktuar nga KCSF për vlerësim do të dalë në vend të ngjarjes për verifikimin e saktësisë të të dhënave të ofruara në ofertë dhe verifikimin nëse objekti i ofruar është i përshtatshëm për KCSF-në.

TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në ftesën për kuotim të çmimit ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

Nëse ofertuesit kanë ndonjë pyetje ose kërkesë për informacion shtesë, ato duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në emailin e cekur në Ftesën për kuotim të çmimit, me kohë për të mundësuar përgjigjen, deri me datë 14 shtator 2021, ora 12:00.

KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë nga ky kuotim dhe thirrje.

KCSF rezervon të drejtën për të negociuar me një ose disa ofertues të listës së ngushtë, pas vlerësimit fillestar të ofertave të dorëzuara.

Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF.

KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkojë takim ose inspektim të vendit/objektit për të ndihmuar procesin e vlerësimit.